

**PLANI I VEPRIMIT PËR REALIZIMIN E RAPORTIMEVE PERIODIKE (FINANCIARE DHE STATISTIKORE)
NË AUTORITETIN E MBIKQYRJES FINANCIARE.**

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në zbatim të akteve të brendshme të Shoqërisë ALBSIG JETË sh.a., Shoqëria ALBSIG JETË sh.a. ndermerr masa për realizimin e raportimeve periodike (financiare dhe statistikore) në Autoritet, si më poshtë.

1. Raportimi periodik në Autoritet do të bëhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në rregulloren e AMF nr. 34/2015 "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit", e ndryshuar duke marrë në konsideratë kushtet e krijuara për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.
2. Në rastet e pamundësisë së komunikimit shkresor dhe për rastet kur kërkohet nga vetë AMF, të përdoret komunikimi elektronik me personat përgjegjës në strukturat e AMF-së.
3. Në rastet e pamundësisë së komunikimit me AMF-në nga personat e ngarkuar në ALBSIG JETË sh.a., të caktohen persona zëvendësues për të siguruar vijimësinë e komunikimit me AMF-në.
4. Drejtuesit e departamenteve të ALBSIG JETË sh.a. të sigurojnë informacionin e nevojshëm për përgaditjen e raportimeve në një kohë sa më të shpejtë.
5. Ky planveprim zbatohet deri në përfundim të pandemisë dhe do të rishikohet për t'u përshtatur në çdo kohë me situatën shkaktuar nga COVID-19.

